



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
Kuvendi i Komunës në Klinë

RREGULLORE
PËR
DHËNIEN E LEJEVE MJEDISORE KOMUNALE (LMK)

Klinë, shkurt 2015

Në bazë të nenit 11, pastaj nenit 12. pika 12.2 nën (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), nenit 32 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr. 03/L-025 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 50), nenit 5 të Ligjit për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L - 214 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 83), në pajtim edhe me Udhëzimin Administrativ të MMPH-së për Dhënie e Lejes Mjedisore Komunale, Nr. 10/2012 të dt.18.06.2012, si dhe nenit 10 parag. 1 pika 3 të Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e vet të rregullt të II-ën më radhë për vitin 2015, të mbajtur më dt. 27.02.2015, e shpall të miratuar:

RREGULLOREN PËR DHËNIEN E LEJES MJEDISORE KOMUNALE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Rregullorja ka për qëllim parandalimin ose zvogëlimin e ndikimit negativ në mjedis të shkaktuar nga subjektet publike dhe private me rastin e realizimit të veprimeve dhe projekteve përkatëse të cilat mund të kenë çrregullime në mjedis.

2. Rregullorja Komunale përcakton rregullat e procedurave për identifikimin, vlerësimin, raportimin e ndikimit të projekteve të caktuara në mjedis dhe zhvillimin e procedurave administrative gjatë procesit të marrjes së vendimit nga ana e Komunës për lëshimin e Lejes Mjedisore Komunale duke siguruar të gjitha të dhënat e rëndësishme lidhur me mjedisin dhe duke siguruar që ato janë marrë parasysh para lëshimit të lejes mjedisore.

Neni 2 Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje përcaktohen përkufizimet dhe nocionet juridike që përdoren në këtë Rregullore, si dhe bëhet sqarimi i tyre si në vijim:

- 1.2. **GLN** -Gaz i lëngëzuar naftor;
- 1.3. **MMPH** - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- 1.4. **DUMM**-Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- 1.5. **ZMM** - Zyra për Mbrojtje të Mjedisit;
- 1.6. **Përgjegjësi i ZMM** - Përgjegjësi i Zyrës për Mbrojtjen e Mjedisit;
- 1.7. **LMK-Leje Mjedisore Komunale** - është dokument me shkrim që e lëshon Komuna dhe është pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik, për veprimtari që kanë ndikim dhe mund të shkaktojnë çrregullime në mjedis, dhe e cila leje bëhet gjatë procedurës së marrjes së lejes ndërtimore, krejt kjo në kuptim të nenit 32 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr. 03/L-025 dhe në pajtim më dispozitat e kësaj Rregulloreje;

1.8. **Raporti për leje mjedisore komunale (Raport i LMK-së)**- nënkupton raportin e shkurtër për ndikimet e aktiviteteve ose projekteve në mjedis të cilin e harton personi fizik apo juridik, si aplikues, e këtë në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe nenit 6 dhe 7 të UA të MMPH-së, nr.10/2012.

1.9. **KP -Sipas kësaj Rregulloreje** nënkupton Komisionin Profesional komunal, i cili bën vlerësimin e raportit të ndikimit në mjedis dhe i cili është i obliguar që të jep mendimin për miratimin apo refuzimin e dhënies së LMK-së.

Neni 3

Autoriteti kompetent për lëshimin e Lejes Mjedisore Komunale-LMK-së

Autoriteti kompetent për zhvillimin e procedurës për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, është Komuna, përkatësisht Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 4

Aplikimi për marrjen e Lejes Mjedisore Komunale

4.1 Aplikimi për Leje Mjedisore Komunale bëhet në Komunë, gjatë procedurës për marrjen e Lejes Ndërtimore.

4.2 Objektet afariste ekzistuese, që nuk kanë Leje Mjedisore, duhet të pajisen me leje sipas kësaj Rregulloreje dhe ligjeve në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

4.3 Aplikimi përmban raportin e shkurtër për ndikimin e aktiviteteve të projekteve në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e ndikimit në mjedis, sipas Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis nr. 03/L-214.

Neni 5

Paraqitja e kërkesës

1. Për marrjen e Lejes Mjedisore Komunale, aplikuesi duhet të dorëzojë në Komunë kërkesën të cilës i bashkëngjiten këto dokumente:

1.1. Kërkesa;

1.2. Certifikata e regjistrimit të biznesit;

1.3. Fleta poseduese;

1.4. Kopja e planit me koordinata;

1.5. Nëse nuk është pronar, kontrata për shfrytëzimin e ngastrës; dhe

1.6. Raporti për LMK, në tri (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) kopje në formë elektronike;

Neni 6

Përmbajtja e raportit për marrjen e Lejes Mjedisore Komunale

1. Raporti për marrjen e Lejes Mjedisore Komunale, përmban:
 - 1.1. Përshkrimin e projektit;
 - 1.2. Përshkrimi i procesit teknologjik, pajimet;
 - 1.3. Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimit në mjedis;
 - 1.4. Përshkrimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis; dhe
 - 1.5. Raporti për marrjen e LMK-së, nuk duhet të jetë me shumë se dhjetë(10) faqe dhe duhet të përmban të dhënat personale të hartuesit.

Neni 7

Përpilimi i Raportit për marrjen e Lejes Mjedisore Komunale

1. Raporti për marrjen e Lejes Mjedisore Komunale, hartohet nga personi fizik ose juridik dhe i cili përmban kushtet dhe kriteret si nga neni 6 dhe 7 i UA të MMPH-së nr. 10/2012.
2. Raporti nënshkruhet nga hartuesi dhe aplikuesi.
3. Hartuesi dhe aplikuesi i Raportit të LMK-së, është përgjegjës për saktësinë e të dhënave të përfshira në Raport.

Neni 8

Komisioni Profesional për vlerësimin e raportit të ndikimit në mjedis

1. Komisioni Profesional e formon Kryetari i Komunës dhe ai përbehet prej 3 anëtarëve, Udhëheqës (zyrtari/ja) e mjedisit dhe dy anëtarë të tjerë me profesione përkatëse sipas natyrës së kërkesës që paraqiten për shqyrtim.
2. Komisioni profesional në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Raportit duhet të jep mendimin me shkrim i cili është parakusht për miratimin ose refuzimin e dhënies së LMK-së.

Neni 9

Aplikuesi ka të drejtë të parashtrojë ankesë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përmes organi komunal që ka vendosur lidhur me LMK-ën, ankesa bëhet kundër vendimit për refuzimin e dhënies së Lejes Mjedisore Komunale, brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e publikimit të Vendimit për LMK.

Neni 10

Afati për miratim

1. Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të kërkesës me raport të LMK-ës dhe në bazë të vlerësimit për miratim apo refuzim nga Komisionit Profesional, Zyrtari i Mjedisit miraton apo refuzon dhënien e Lejes Mjedisore Komunale.
2. Subjektet afariste ekzistuese, të cilat nuk janë të pajisura me Lejes Mjedisore Komunale, duhet të pajisen më LMK-në, sipas kësaj Rregullore dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale nr. 10/2012.
3. Leja Mjedisore Komunale lëshohet për periudhën jo me gjatë se dhjetë (10) vjet.

Neni 11

Në rast të çrregullimeve apo aksidentit në procesion teknologjik (pajimeve) të subjektit afarist, të cilat mund të shkaktojnë rrezik të drejtpërdrejtë ose tërthortë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, Komuna përkatësisht Inspektori i Mjedisit, e shpall gjendjen e mjedisit të rrezikuar, ndërsa personi juridik dhe fizik duhet që menjëherë të ndërmerr masa të sanimit të gjendjes sipas raportit të Lejes Mjedisore Komunale, të paraparë për mbrojtje me shpenzimet e veta.

Neni 12

Transferimi i Lejes Mjedisore Komunale

1. Në rast se aplikuesi për Leje Mjedisore Komunale, ose poseduesi, planifikon të transferojë kërkesën ose lejen të ndonjë person tjetër-trashëgues përkatësisht suksesor, aplikuesi për LMK ose poseduesi i asaj leje dhe trashëguesi-suksesori duhet të paraqes një kërkesë të përbashkët lidhur më transferimin.
2. Kërkesës për transferim i bashkëngjitet Leja Mjedisore Komunale origjinale.
3. Komisioni shqyrton transferimin e kërkesës ose LMK-së duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese dhe arsyet e transferimit apo mos transferimit të saj.

Neni 13

Ndërprerja e vlefshmërisë së Vendimit për LMK

1. Ndërprerja e vlefshmërisë së Vendimit për LMK bëhet nëse:
 - 1.1. Investitori nuk fillon realizimin e projektit në afat prej një (1) viti;
 - 1.2. Nuk i përmbush kushtet e përcaktuara me Lejen Mjedisore Komunale, dhe
 - 1.3. Në afatin e dhënë, nuk vepron sipas udhëzimeve, këshillave të inspektorit ose nuk ndërmerr masat e kërkuara nga ai.

Neni 14
Vazhdimi i afatit të Lejes Mjedisore Komunale

Dy muaj para skadimit të afatit të Lejes Mjedisore Komunale, investitori duhet të parashtrijë kërkesë për vazhdimin e afatit të LMK-së, sipas procedurës së njëjtë që parashihej për marrjen e saj.

Neni 15
Regjistri i Lejeve Mjedisore Komunale

1. Komuna mban regjistrin e Lejeve Mjedisore Komunale, i cili përmban:

- 1.1. Numrin identifikues të investitorit, llojin e veprimtarisë;
- 1.2. Adresën dhe selinë e investitorit;
- 1.3. Datën e lëshimit dhe afatin e Lejes Mjedisore Komunale;
- 1.4. Lokacionin e projektit; dhe
- 1.5. Fletëpagesën për LMK.

II. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 16
Kundërvajtjet

Me gjobë në të holla prej pesëmijë (5,000.00 €) deri në dhjetëmijë euro (10,000.00 €) gjobitet për kundërvajtje personi juridik ose fizik nëse jep të dhëna jo të sakta në Raportin e LMK-së dhe në përputhje me procedurat nga Ligji për Kundërvajtje dhe nenin 15 të UA të MMPH-së nr. 10/2012.

Neni 17

1. Më gjobë në të holla prej 250,00 € (dyqind e pesëdhjetë euro) deri në 500,00 € (pesëqind euro), dënohen të gjitha subjektet afariste ekzistuese, të cilat nuk janë të pajisura me Leje Mjedisore Komunale dhe nuk e kanë të paguar taksën, sipas kësaj Rregulloreje.

2. Më gjobë në të holla prej 500,00 € (pesëqind euro) deri në 5,000.00 € (pesëmijë euro), do të dënohen të gjitha subjektet të cilat e kanë LMK-ën dhe nuk i përmbahen raportit të saj dhe vetë LMK-ës.

III. DISPOZITAT E FUNDIT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 18

Rregullores i nënshtrohen të gjitha subjektet afariste, të cilat operojnë në territorin e Komunës së Klinës, që nuk i janë nënshtruar deri më tani procedurave sipas Ligjit për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis, që është në fuqi.

Neni 19

Të gjitha subjektet ekzistuese do njoftohen me shkrim nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Klinë, përmes tabelës së shpalljeve për miratimin e Rregullores Komunale për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, po ashtu edhe për kushtet dhe kriteret për vazhdimin e saj.

Njoftimi me Rregulloren komunale dhe publikimi i saj

Neni 20

Rregullorja komunale pas hyrjes në fuqi do të bëhet transparente në tabelën e shpalljeve të Komunës si dhe do të publikohet përmes Zyrës së Informimit dhe Zyrës së Teknologjisë informative në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Neni 21

Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është shtojca e bashkangjitur.

Neni 22

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Klinë, Zyra për Mbrojtje të Mjedisit dhe Inspektori i Ambientit nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Zgjidhja e kontesteve

Neni 23

Për zgjidhjen e kontesteve që kanë të bëjnë me Leje Mjedisore Komunale dhe shkaktimin e dëmeve eventuale që ndërlidhen më to dhe që kanë për pasojë çrregullimin dhe dëmtimin eventual të mjedisit kompetente për vendosje gjyqësore do të jetë Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë.

Neni 24

Në rast të kolezionit të dispozitave të kësaj Rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale-LVL-ën apo edhe Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, si dhe akteve të tjera të Pushtetit qendror dhe ministror të linjës, si dhe në raste të zbrazëtirës tjetër juridike, në këtë Rregullore, drejtpërsëdrejti vlejnë dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 i dt. 20 shkurt 2008, apo edhe dispozitat e Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, si dhe akteve të tjera të Pushtetit qendror dhe ministrisë kompetente të linjës që rregullon çështjen lëndore deri në harmonizimin ligjor të këtij akti.

Hyrja në fuqi

Neni 25

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës, kjo në kuptim të nenit 18 i Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 01/2013 dt. 24.01.2013, për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të akteve komunale.

Nr. 01- 351-1673 /2015
Klinë, më dt. 27.02. 2015

KUVENDI I KOMUNËS



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi

SHTOJCA

e

Listës së aktiviteteve të bizneseve të specifikuara sipas veprimtarive që i nënshtrohen pagesës më rastin e marrjës së Lejes Mjedisore Komunale-LMK-së

1. Grupi i parë - 300,00€

1. Fabrika për përpunim druri, mobilieri, tapiceri deri 1000m³ në vit,
2. Fabrika për ambalazhimin e ujit natyral, mineral me kapacitet deri në 0.5 m³ në ditë,
3. Fabrika për prodhimin e lëngjeve frutash, pije freskuese; pijesh alkoolike me kapacitet deri në 0.5 m³ në ditë,
4. Fabrika për përpunim të qumështit dhe produkteve të tij, deri 1000 lit. ose kg në ditë,
5. Fabrika për përpunim të vajrave bimore, luledielli etj. me kapacitet 500 lit. në ditë,
6. Prodhimi i gëlqeres (shuarja) deri 100 ton në vit,
7. Prodhimi i betonit dhe elementeve parafabrikate, pllakave etj. me kapacitet deri në 50 m³ beton në ditë,
8. Magazinimi i lubrifikantëve të ambalazhuar në vende prodhim,
9. Grumbullimi i mbeturinave të konstruktiv demolim për qëllime të riciklimit përfshirë seleksionimin, copëtimin mekanik dhe deponimin e tyre si dhe caktimin e vendit për deponim,
10. Prodhimi i këpucëve dhe aksesorëve të tjerë të ngjashëm, pa procese kimike (qepje, ngjitje, montim etj.),
11. Prodhimi i kartonit dhe ambalazheve të tjerë, me kapacitet deri 500 kg në ditë, dhe
12. Rritja artificiale e peshkut në hurdha, me sipërfaqe deri në 300 m².

2. Grupi dytë - 250,00€

1. Pikëshitjet e gazit (GLN) deri 4.9 m³,
2. Thertore me kapacitetet deri 3 gjedhë në ditë,
3. Fabrika për përpunim të pemëve dhe perimeve deri në 1000 kg në ditë,
4. Punishtet e vogla për përpunim të mermerit, me sipërfaqe totale-objekti deri në 200 m³
5. Ndërtimi i objekteve të banimit dhe shërbimeve, me sipërfaqe ndërtimi më të madhe se 1000 m²
6. Magazinat frigorifer, për produktet ushqimore të ambalazuara me kapacitet total magazinues deri në 50 ton.

3. Grupi i tretë- 150,00€

1. Sharrimi i lëndës drunore,
2. Furrat për prodhim të bukës dhe produkteve të miellit,
3. Pikat e magazinimit dhe tregtimit të materialeve të ndërtimit,
4. Impiantët për rritjen intensive të shpezëve, derrave, bagëtive të imta dhe të mëdha që kanë më pak se :
 - a). 2000 shpend,
 - b). 100 derra,
 - c). 30 gjedhë, dhe
 - d). 200 bagëti të imëta.

4. Grupi i katërt- 100,00€

1. Autoserviset,
2. Veprimtaria e prodhimit të kompostit, me sasi totale përpunimi deri në 100m³ ose 40 ton gjatë vitit,
3. Vendet ku janë të magazinuara, më pak se 10 ton mbeturinë inerte,
4. Vendet ku janë të magazinuara, më pak se 2 ton mbeturinë e pa rrezikshme, dhe
5. Impiantet për riciklimin dhe prodhimin e masave plastike me kapacitet deri 1000 ton në vit.

5. Grupi i pestë- 50,00€

1. Autolarjet,
2. Magazinimi i plehrave kimike dhe pesticideve me kapacitet magazinues deri në 10 ton,
3. Qebaptoret dhe gjellëtoret,
4. Vendet e tregimit të kafshëve në ambient të hapur (tregjet tradicionale) ose të mbyllura, dhe
5. Tregjet urbane industriale dhe të produkteve bimore dhe shtazore.

6. Grupi i gjashtë - janë të liruara nga pagesa.

Projektet publike

1. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitimet e tyre në gjatësi deri 5 km,
2. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitim i ujësjellësve ekzistues në gjatësi deri 5 km,
3. Rikonstruksion i rrugëve urbane dhe rurale ekzistuese dhe ndërtimi i akseve të reja rrugore (me gjatësi deri në 2 km),
4. Plantacionet e drurëve frutore,
5. Projektet e përmirësimit të pyjeve, pyllëzime, sistemime etj., dhe
6. Projektet e objekteve të përfituara nga grantet apo donacionet e ndryshme.